

VARIANTET:

- Në varësi të tekstit mund të caktohet për çdo grup një skenë e vetme nga tregimi. Në përfundim skenat do të ndërlidhen së bashku dhe do të prezantohen pastaj si pjesë e përbashkët teatrore. Së fundi, skenat janë të lidhura së bashku dhe kryhet si një lojë të vazhdueshme.
- Për lojën imagjinare ose dramatizimin e teksteve janë të përshtatshme gjithashtu edhe kukullat- gishta ose lojërat- hije në projektor.

VËREJTJE:

- Për t'ia dhënë N leksikon e nevojshëm, mund të shënohen në dërrasë të zezë mjete të rëndësishme të të folurit dhe të diskutohen para dhënies së detyrës; krahaso për këtë udhëzimet te nr. 26.
- Në varësi të tekstit, afër aktorëve/eve duhet që të caktohet edhe një fëmijë si tregimtar/e.
- Aktorët/et flasin para një publiku të madh. Për këtë arsye, N duhet tu bëhet e qartë në këtë ushtrim se sa e rëndësishme është që të kenë shqiptim të qartë. Ky është sigurisht njëri nga kriteret, të cilëve u kushtojnë vëmendje fëmijët shikues gjatë lojës.

# 28

## Lojëra teatrore shkollore

### Qëllimi

*Nëpërmjet lojës teatrore shkollore forcohen kompetencat e paraqitjes personale, prezantimi i lirë, raporti me gjestet, mimika dhe gjuha krijuese dhe e pastër si dhe zgjerohet repertori leksikor dhe sintaksor në gjuhën e parë. Kompetencat e fituara në forma të thjeshta (krahaso nr. 8 dhe 27) do të përmbliidhen këtu dhe i shërbejnë, në korniza motivuese, vënies në skenë të pjesëve më të mëdha.*

kl. 3-9


180 min.



Materiali:  
Rekuizitat.

Rrjedha:

- Së bashku me N do të shkruhet ose një skenar për pjesë teatrore ose një tregim ekzistues do të rishkruhet dhe dialogohet (të dy variantet janë njëkohësisht edhe projekte jashtëzakonisht të dobishme në të shkruar). Është gjithashtu e mundshme që të merret një tekst i gatshëm dhe të vëhet në skenë.
- Pastaj skenat e veçanta do të ushtrohen. Do të bëhen ushtrime për shqiptimin dhe do të diskutohen dhe provohet përdorimi i gjuhës së trupit, shprehjeve të fytyrës dhe gjesteve.
- Do të organizohen rekuizitat do të planifikohet prezantimi përfundimtar (hapësira, programi, ftesat, aperitiv etj).



- Skenat do të studiohen njëra pas tjetrës, në mënyrë që N të fitojnë besim dhe M të mund të tërhiqet në prapaskenë gjithnjë e më shumë.
- Në aspektin e proceseve të të mësuarit është e rëndësishme që N t'i japin vazhdimisht feedback njëri-tjetrit. Për këtë qëllim do të vendosen paraprakisht kriteret dhe pikat e vëzhgimit.
- Skenat do të bashkohen gradualisht, ashtu që në fund pjesa teatrore të jetë e përfunduar.
- Vënia në skenë duhet të mbahet brenda një kuadri të përshtatshëm, p.sh. në kontekstin e një mbrëmjeje me prindër me ftesa, fletën e programit dhe aperitiv.

---

Vërejtje:

- Është e mundshme që grupet e moshave të ndryshme në MGJP të ushtrojnë nga një pjesë, ashtu që në mbrëmjen përfundimtare të paraqiten p.sh., tri pjesë të vogla ose skeçe.
- Në mënyrë që N të mësohen me lojën teatrore, është e rëndësishme që të fillohet së pari me pjesë të vogla teatrore dhe pastaj kërkesat të rriten në mënyrë të vazhdueshme.